

VENDIM
Nr. 51, datë 21.1.2015

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQES, NË
NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE “MAMËZ-KALIMASH”, TË RRETHIT
KUKËS, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA “VLLAZNIMI DEDA IMPORT-
EKSPORT” SHPK, PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT MINERAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 4.1 ha, në ngastrat 77/b, 77/c, 78/a, 78/b, të ekonomisë pyjore “Mamëz-Kalimash”, që do të përdoret nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit të kromit, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për sipërfaqet, sipas ngastrave pyjore, jepen në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të volumit të lëndës drusore, në sipërfaqen e hequr, dhe të infrastrukturës së saj të paguhen nga subjekti “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., bazuar në lidhjen nr. 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen e marrë në përdorim, sipas planit të rehabilitimit mjedisor dhe, brenda 3 viteve të para të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe prej 4.1 ha fond pyjor në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës të bëjë çregjistrimin e sipërfaqeve pyjore, të identifikuara sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “tokë e zënë pyjore” në kategorinë “tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes pyjore, nga shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., kjo sipërfaqe të regjistrohet si pjesë e fondit pyjor dhe kullor publik.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Kukës dhe shoqëria “Vllaznimi Deda Import-Eksport” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "VLLAZNIMI DEDA IMPORT EKSPORT" sh.p.k.
në qarkun e KUKËSIT**

QARKU Kukës

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullosore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)</i>
KU 32 00	Mamez - Kalimash	77 b	Ministria Mjedisit	1.02
KU 32 00	Mamez - Kalimash	77 c	komuna Surroj	0.3
KU 32 00	Mamez - Kalimash	78 a	Ministria Mjedisit	0.67
KU 32 00	Mamez - Kalimash	78 b	komuna Surroj	2.11
GJITHSEJ				4.10



